



Pranuar / Dostiguar Prenheno / Predato Received / Delivered	31.10.2023	3	viti god year
Organ / Shënia Organ / Jedinstvo Org / Unit	SKIMSUCK	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
	6791/2023		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1191/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1191/2023 të datës 21.09.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë [redacted] kundër organit të punësimit Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Kompensim material-vëllim i shtuar i punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Lënda në lidhje me ankesën A.nr.1191/2023 të datës 21.09.2023 e ankueses [redacted] Kthehet në Rishqyrtim dhe Vendosije tek Zyrtari Kryesor Administrativ i Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- II. Obligohet Zyrtari Kryesor Administrativë i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë zbatimin e të njëjtit, të bëjë rishqyrtimin e kësaj lënde.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes se veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsy e tim

Mes ankueses [redacted] e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 07.05.2012 në pozitën *Menaxhere për Buxhet dhe Financa* në Shërbimin Korrektues të Kosovës, dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës më 08.08.2023 është lidhur marrëveshja për punë me vëllim të shtuar e vlefshme nga data 08.08.2023 deri më datë 13.03.2024.

Më datë 09.08.2023 është proceduar për pagesë sipas kësaj marrëveshje në shumë prej 154 në Thesarin e Kosovës, mirëpo meqë nuk është realizuar kjo pagesë Menaxheri i Personelit i Shërbimit Korrektues të Kosovës përmes emailit të datës 28.08.2023 dhe 05.09.2023 ka kërkuar nga zyrtarët e Thesarit të njoftohen pse nuk është bërë pagesa sipas marrëveshjes dhe kërkesës së tyre. nuk është realizuar, ndërsa zv. i Udhëheqësit të Divizionit të Pagesave në Thesarin e Kosovës ka njoftuar se përmes përgjigjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit shtesat e parapara me Ligjin e Pagave përveç vendimeve të Organizatave Buxhetore duhet të kenë edhe aprovimin e Ministrit të Financave.

Ankuesja, ndaj mos pagesës së shtesës për vëllim të shtuar në punë, me datë 21.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6180/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 25.09.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 03.10.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6180/2023 të datës 21.09.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit të datës 07.05.2012; Certifikatë e datës 26.01.2021 dhe 11.11.2021; Autorizim i datës 26.01.2021; Kërkesë për mjete shtesë për punë me vëllim të shtuar e datës 18.07.2023; Marrëveshje për punë me vëllim të shtuar me Nr. Port: 1032 e datës 08.08.2023; Kërkesën për pagesë retroaktive e datës 09.08.2023. Emailin e datës 28.08.2023 dhe 05.09.2023 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 18.09.2023 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 07.07.2023 nga [redacted] për [redacted] Konkursin e datës 28.03.2012; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 25.09.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 03.10.2023.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore që lënda të **Kthehet në Rishqyrtim dhe Vendosje** të Zyrtari Kryesor Administrativ i Shërbimit Korrektues të Kosovës, *Sepse:*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që përkundër marrëveshjes dhe mjeteve buxhetore nuk është bërë pagesa

për punë me vëllim të shtuar e që kjo e drejtë është e garantuar me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe Rregulloren Nr. 08/2023 për Shtesat në Sektorin Publik.

Kolegji i Këshillit me rastin e shqyrtimit të shkresave kryesore që lidhen me pretendimin e ankueses mori për bazë dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik që ka hyrë në fuqi me 05.02.2023, i cili ligj në nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin parasheh: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", ndërsa në nenin 22 paragrafin 1 të këtij ligji parashihen shtesat që mund përfitohen nga zyrtaret publikë:" 1.Shtesat që mund përfitohen në bazë të këtij ligji janë : 1.1. shtesa e veçantë për të zgjedhurat/it; 1.2. shtesa për kushte tregu të punës; 1.3. shtesa e performancës; 1.4. shtesa për kushte specifike të punës; 1.5. shtesa për punën pa orar të paracaktuar; 1.6. shtesa për vëllimin e punës; 1.7. shtesa për licencë të avancuar për nëpunësen/in e arsimit para universitar; 1.8. shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor; 1.9. shtesa e performancës për krijuesen/in dhe performuesen/in e artit dhe kulturës; 1.10. shtesa funksionale. Ndërsa me nenin 28 është rregulluar mënyra e përfitimit të shtesës për vëllimin e punës ku parashihet se: "1. Organizatat buxhetore, në rastet e parashikuara nga ky ligj, mund të japin shtesën për vëllim të punës, për kryerjen e punës për shkak të rritjes së vëllimit të punës, nëse kanë mjete në dispozicion për këtë qëllim nga kursimet e fondeve të pagave që krijohen për shkak të mungesës së nëpunësve/ve civil, apo pozitive të paplotësuara për të cilat janë paraparë mjete në planin financiar të shfrytëzuesit buxhetor dhe fonde për projekte të veçanta. 2. Nëpunëset/it civil përfitojnë shtesën për shkak të rritjes së vëllimit të punës, për punën e kryer dhe që tejkalon rezultatet e pritshme të punës në një (1) muaj, nëse në këtë mënyrë është e mundur të sigurohet një mënyrë më racionale arritja e rezultateve të punës si dhe buxheti. 3. Shtesa për vëllimin e punës miratohet nga zyrtarja/i kryesor administrativ i institucionit, pas marrëveshjes me nëpunësen/in civil për të punuar me vëllim të shtuar. 4. Shtesa e përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni, nuk mund të jetë më e lartë se 0.5% e fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore, për pagën bazë të zyrtareve/ëve publik të organizatës buxhetore në të njëjtin vit financiar. 5. Për qëllim të zbatimit të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës do të trajtohet si një (1) organizatë buxhetore. 6. Rregullat për fitimin, vlerën e shtesës si dhe periudhën e përfitimit përcaktohen me akt nënligjor të Qeverisë, me propozim të ministrisë përgjegjëse për financa dhe me pëlqim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike. 7....".

Kolegji i Këshillit në lidhje me objektin e kësaj ankese po ashtu ka konstatuar se Qeveria e Republikës së Kosovës më datë 06.02.2023 ka nxjerrë Rregulloren (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik ku në nenin 1 të kësaj rregullore është përcaktuar qëllimi i saj ku theksohet "1. Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë kriteret, kushtet, rregullat, mënyrën e llogaritjes dhe procedurën për përfitimin e shtesave të mëposhtme për të punësuarit në sektorin publik:"..... 1.3. shtesa për vëllimin e punës.....,etj", ndërsa në nenin 9 të kësaj rregullore janë përcaktuar kriteret dhe procedura për përfitimin e shtesës për vëllimin e punës si: 1. Shtesa për vëllimin e punës mund të përfitohet nëse në këtë mënyrë është e mundur të sigurohet në mënyrë më racionale arritja e rezultateve të punës, si dhe buxheti. 2. Udhëheqësi i Njesisë dhe/apo Zyrtari Kryesor Administrativ mund t'i kërkojë një apo më shumë nëpunësve civil që të angazhohen me vëllim të shtuar të punës për një periudhë të caktuar kohore që nuk e tejkalon një (1)

vit. 3. Periudha kohore e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni mund të vazhdohet me marrëveshje të re dhe pëlqimin e të dyja palëve. 4. Në asnjë rast totali i periudhës në të cilën nëpunësi civil punon me vëllim të shtuar nuk mund të kalojë periudhën prej dy (2) viteve të njëpasnjëshme. 5. Shtesa për vëllimin e punës miratohet me lidhjen e marrëveshjes nga zyrtari kryesor administrativ i institucionit me nëpunësin civil për të punuar me vëllim të shtuar, sipas Shtojcës 1, pas konfirmimit nga njësia përkatëse për buxhet dhe financa se nuk është tejkaluar limiti buxhetor, konform njoftimit të përcaktuar në paragrafin 10 të këtij neni. 6. Vlera e shtesës për vëllim të punës është deri në njëzetë përqind (20%) e pagës bazë të nëpunësit civil. 7. Shtesa për vëllimin e punës duhet të ndërpritet në momentin e pushimit të ekzistimit të rrethanave për të cilën është dhënë shtesa. 8. Përderisa nuk përcaktohet ndryshe me ligj, tërësia e shtesave të dhëna sipas këtij neni nuk mund të jetë më e lartë se 0.5% e fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore, për pagën bazë të zyrtarëve publik të organizatës buxhetore në të njëjtin vit fiskal. 9. Për qëllim të zbatimit të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës do të trajtohet si një (1) organizatë buxhetore. 10. Ministri përkatës për financa, brenda kufizimeve ligjore, priorizon shpërndarjen e fondeve në dispozicion për shtesën e vëllimit të punës sipas paragrafit 8 dhe 9 të këtij neni tek institucionet dhe i njofton, duke marrë parasysh kriteret si në vijim: 10.1. numrin e të punësuarve në Organizatën Buxhetore dhe mungesat e stafit; dhe 10.2. organizatat buxhetore ku fusha e përgjegjësisë administrative e dy (2) apo më shumë ministrive është bashkuar/fuzionuar në një ministri. 11. Ministria përgjegjëse për financa ka për obligim që të sigurohet se totali i shtesave për vëllim të punës, nuk tejkalon kufirin e përgjithshëm buxhetor të përcaktuar me legjislacionin në fuqi'. Andaj Kolegji i Këshillit bazuar në dispozitat e lartshënuara të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, konstaton se realizimi i shtesës për vëllimin e punës për ankuesen mund të bëhet vetëm pas respektimit të proceduarve sipas Ligjit dhe kësaj Rregullore të apostrofuara si më lartë respektivisht shtesa për vëllimin e punës realizohet vetëm pas miratimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ i organit të punësimit gjegjësisht me lidhjen e marrëveshjes nga i njëjti me nëpunësin për të punuar me vëllim të shtuar por gjithnjë duke respektuar legjislacionin në fuqi në lidhje me këtë çështje nga se sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik në nenin 28 paragrafi 1 parashihet: "1. Organizatat buxhetore, në rastet e parashikuara nga ky ligj, mund të japin shtesën për vëllim të punës, për kryerjen e punës për shkak të rritjes së vëllimit të punës, nëse kanë mjete në dispozicion për këtë qëllim nga kursimet e fondeve të pagave që krijohen për shkak të mungesës së nëpunësve/ve civil, apo pozitive të paplotësuara për të cilat janë paraparë mjete në planin financiar të shfrytëzuesit buxhetor dhe fonde për projekte të veçanta", si dhe Rregulloren (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik përkatësisht nenin 8 specifikohet: "5. Shtesa për vëllimin e punës miratohet me lidhjen e marrëveshjes nga zyrtari kryesor administrativ i institucionit me nëpunësin civil për të punuar me vëllim të shtuar, sipas Shtojcës 1, pas konfirmimit nga njësia përkatëse për buxhet dhe financa se nuk është tejkaluar limiti buxhetor, konform njoftimit të përcaktuar në paragrafin 10 të këtij neni".

Kolegji i Këshillit referuar asaj që u tha si më lartë dhe në vështrim të vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankueses me rastin e vendimmarrjes mori për bazë dispozitat ligjore mbi të cilën është lidhur marrëveshja për punën me vëllim të shtuar e datës 08.08.2023, gjegjësisht nenin 28 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik ndërsa bazuar në këtë

dispozitë mori për bazë edhe paragrafin 6 të këtij neni ku parashihet *''6.Rregullat për fitimin, vlerën e shtesës si dhe periudhën e përfitimit përcaktohen me akt nënligjor të Qeverisë, me propozim të ministrisë përgjegjëse për financa dhe me pëlqim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike''*.

Kolegji i Këshillit bazuar në çështjet që u elaboruan më lartë dhe duke marrë për bazë pretendimet ankimore të ankueses, konstaton se nga shkresat e lëndës të dorëzuara nga palët në këtë procedurë konstaton se nga organi i punësimit në lidhje me objektin e kësaj ankese dhe me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes për punën me vëllim të shtuar me datë 08.08.2023, nuk është argumentuar me prova konkrete se janë respektuar dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik përkatësisht neni 28, dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik përkatësisht neni 8.

Andaj Kolegji i Këshillit referuar bazës ligjore të marrë për bazë me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese e të specifikuar në këtë arsyetim, konstaton se është obligim i organit të punësimit që të rishqyrtoj edhe njëherë lëndën duke përfshi edhe marrëveshjen për punën me vëllim të shtuar të datës 08.08.2023, se me rastin e nënshkrimit të së njëjtës a janë respektuar dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik që specifikisht rregullojnë kompensimin për *''Shtesa për vëllimin e punës''*, ngase nga përgjigja që kemi marrë nga organi i punësimit nuk na janë dorëzuar prova që argumentojnë respektimin e hapave që i parasheh legjislacioni i potencuar si më lartë, andaj pas rishqyrtimit të kësaj lënde duke përfshi edhe marrëveshjen e datës 08.08.2023, Zyrtari Kryesor Administrativë i Shërbimit Korrektues të Kosovës të vendos përmes aktit administrativ që duhet të jetë në harmoni me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative respektivisht me nenin 47 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1,1.2,1.3 dhe 1.4 si dhe nenin 48 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1,1.2,1.3,1.4,1.5 dhe 1.6.

Bazuar në at që u tha si më lartë , e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1191/2023, datë 31/10/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.